

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Spring 4-2021

KRIZA JUGOSLLAVE – RASTI I KOSOVËS

Anesa Ferati

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Political Science Commons](#)

Recommended Citation

Ferati, Anesa, "KRIZA JUGOSLLAVE – RASTI I KOSOVËS" (2021). *Theses and Dissertations*. 2619.
<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/2619>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



Kolegji UBT
Fakulteti i Shkencave Politike

KRIZA JUGOSLLAVE – RASTI I KOSOVËS
Shkalla Bachelor

Anesa Ferati

Prill/2021
Prishtinë



Kolegji UBT
Fakulteti i Shkencave Politike

Punim Diplome
Viti akademik 2017/18

Anesa Ferati

KRIZA JUGOSLLAVE – RASTI I KOSOVËS
Mentori: Dr. Hajdi Xhixha

Prill/2021

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Synimi i këtij punimi bachelor është trajtimi i çështjes së Kosovës në ish-Jugosllavi gjatë viteve 1990-1999. Ky punim shtjellon çështjen e vetëvendosjes, përpjekjen e shqiptarëve për të qenë të lirë nga okupimi serb. Një luftë nga ana e popullit të Kosovës e cila kishte karakter çlirimtar duke u sfiduar me mënyra më të ndryshme dhe të dhunshme nga ana e serbëve. Si pasojë e përpjekjeve për lirinë e tyre, ata nuk morën asgjë tjetër përpos rrahjeve, burgosjeve, vrasjeve, dhunimeve, shkatërrimeve, plaçkitjeve, djegjeve, masakrimeve, duke mos i kursyer as gratë e deri tek fëmijët. Ky punim përmban ecurinë e ngjarjeve kryesore duke filluar nga një përshkrim i shkurtër i viteve më të hershme dhe duke vazhduar kështu me çështjet kryesore të viteve 90'-99' ku përfshihen Komisioni i Badinterit, Marrëveshja Dayton dhe deri tek shpërthimi i Luftës së Kosovës në të cilën bënë pjesë Konferenca e Rambouillet. Gjithashtu ky punim është pasuruar me intervista të bashkëvuajturve, çka e plotësojnë punimin me detaje shtesë të rëndësishme. Kosova me vite u kontrollua nga Serbia në mënyrë indirekte përmes Federatës dhe u arrit që udhëheqja e saj me dekada të jetë serbo-malazeze. Përderisa, shqiptarët nuk u ndalën asnjëherë duke kërkuar liri, drejtësi, barazi dhe Republikë.

Fjalët kyçe: *populli shqiptar, serbët, luftë, konflikt, masakra, sulme, liri, vetëvendosje.*

MIRËNJOHJE DHE FALENDERIME

Në përfundim të studimeve dhe temës së diplomës, shfrytëzoj rastin të falenderoj familjen time si dhe mentorin e temës Hajdi Xhixha, për çdo arritje, çdo ndihmë dhe përkrahje gjatë gjithë kësaj periudhe. Ju jam shumë mirënjohëse!

PËRMBAJTJA

LISTA E TABELAVE	IV
LISTA E SHKURTESAVE	V
1. Hyrje	1
1.1. Përjetimet e një të afërmi gjatë periudhës së ish-Jugosllavisë	3
2. SHQYRTIMI I LITERATURËS	5
2.1.2. Konferenca e paqes dhe Komisioni Badinter (1991-1995).....	6
2.1.3. Marrëveshja në Dayton (1995-1998)	10
2.2. Shpërthimi i luftës në Kosovë.....	13
2.2.1. Konferenca e Rambouillet.....	15
2.2.2. Familja ime gjatë luftës	17
2.3. Krimet e Luftës në Kosovë	19
2.3.1. Disa nga masakrat të paraqitura në tabela	19
3. DEKLARIMI I PROBLEMIT	23
4. METODOLOGJIA	24
5. PËRFUNDIME	25
BIBLIOGRAFIA	26

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Numri i të vrarëve sipas komunave gjatë luftës në Kosovë	20
Tabela 2. Struktura e të gjitha viktimave të vrara sipas moshës	21
Tabela 3. Numri i varrezave masive sipas komunave	21
Tabela 4. Numri i rasteve të vrasjeve në masë sipas komunave	22
Tabela 5. Të dhënat për të vrarët në të gjithë Kosovën 1998-1999.....	22
Tabela 6. Të dhënat për të zhdukur në të gjithë Kosovën 1998-1999.....	22

LISTA E SHKURTESAVE

RSFJ- Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë

LDK- Lidhja Demokratike e Kosovës

KE- Komuniteti Evropian

BE- Bashkimi Evropian

UÇK- Ushtria Çlirimtare e Kosovës

OKB- Organizata e Kombeve të Bashkuara

OSBE- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

LBD- Lëvizja e Bashkimit Demokratik

NATO- Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut

UNMIK- Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

KFOR- Forcat e Kosovës

TMK- Trupat Mbrojtëse të Kosovës

KMDLNJ- Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut

1. Hyrje

Populli shqiptar gjatë historisë shumëshekullore nuk i ka pushuar asnjëherë përpjekjet për liri dhe bashkim kombëtar, duke filluar nga të parët tanë ilirët, e në vazhdimësi deri te historia më e re bashkëkohore. Kosova qysh në kohët e hershme ishte nën sundimin e pushtuesve. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, territori i Kosovës ishte ndarë në tri zona pushtuese nga gjermanët, italianët dhe bullgarët. Është me rëndësi të theksohet se shqiptarët ishin nën Jugosllavi. Që nga atëherë shqiptarët u ngritën në luftë kundër fashistëve pushtues me qëllim të bashkimit të të gjitha trojeve shqiptare etnike në një shtet kombëtar të përbashkët.

Jugosllavia e cila u formua me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, ishte e përbërë nga gjashtë republika dhe dy krahina autonome. Republikat kishin të drejtën e vetëvendosjes poashtu edhe të drejtën e bashkimit dhe ndarjes nga Federata. Krahinat autonome ishin njësi të Serbisë Federale pa këto të drejta, por megjithatë me kompetenca të veçanta dhe autonome. Shteti drejtohej prej një qendre të Federatës, në të cilën ishin të përfaqësuar të gjitha republikat edhe të dy krahinat autonome - Kosova dhe Vojvodina (*Zejnullah 2007: f. 15*).

Pas përfundimit të luftës, Kosova u rikolonizua nga strukturat e Qeverisë Jugosllave, duke e ndarë atë në tri shtete ndërmjet Serbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë. Më 8-10 korrik 1945 në Prizren, strukturat shtetërore serbo-jugosllave e organizuan Konferencën e Këshillit Nacional çlirimtar të Kosovës në të cilën morën pjesë 142 delegatë, ku vetëm 33 prej tyre ishin shqiptarë. Këtu u miratua “projektrezoluta për aneksimin e Kosovës e Metohisë nën Serbinë federale”. Kryesia e Kuvendit popullor të Serbisë e nxori ligjin për formimin e rajonit autonom të Kosovës që u shpall pjesë përbërëse e Serbisë (*V. Krasniqi 2009: f. 14*).

Konflikti jugosllav tërhoqi vëmendjen e të gjithë komunitetit ndërkombëtar. Ky konflikt mund të quhet përmasa shqiptare në konfliktin jugosllav, ndërmjet shqiptarëve etnikë, nga njëra anë, dhe serbëve, maqedonasve dhe malazezëve, nga ana tjetër. Më i rëndësishmi i këtyre konflikteve ka qenë ai i Kosovës, mirëpo probleme serioze ekzistonin edhe tek vendet e tjera. Politika serbe nuk kishte nevojë për shqiptarët, ajo i dëshironte territoret, pasuritë tokësore e nëntokësore të tyre (*Ahrens 2010*).

Kështu, kjo politikë e padrejtë i mobilizoi shqiptarët, duke formuar një lëvizje ilegale politiko-ushtarake, e cila funksionoi 2 vjet. Kishte edhe organizata të tjera, të cilat u formuan mirëpo nuk zgjati shumë deri sa u vërejtën nga pushtuesit dhe në këtë mënyrë u burgosën me dënime kapitale. Përpyekjet e shqiptarëve vazhduan edhe kur u bënë diskutime publike për amandamentet kushtetuese 1967-68 të drejtuara nga Fadil Hoxha, kryetar i atëhershëm i Kuvendit të Kosovës. Për herë të parë më 27 nëntor 1968 u dëgjua në rrugë parulla “Kosova Republikë” nga qindra demonstrues duke filluar nga Prizreni, me qëllim të përhapjes edhe në qendrat tjera të Kosovës. Në këtë protestë u bashkuan edhe studentët në Prishtinë duke arritur kështu kulmin e një demonstrate masive. Si rezultat i këtyre demonstratave u përshpejtua procesi i ndryshimeve kushtetuese, duke u kurorëzuar me Kushtetutën e vitit 1974 (V. Krasniqi 2009).

Kushtetuta e vitit 1974 erdhi me disa të arritura në pika të ndryshme si në arsim, kulturë, ekonomi etj. U hap Universiteti i Prishtinës duke pasur në gjirin e vet disa fakultete si Juridik, Filozofik, Ekonomik, Teknik etj. Po ashtu u themelua Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës si dhe Instituti i Albanologjisë, Historisë. Pozita e femrës shqiptare ndryshoi. Ajo u integrua në të gjitha institucionet shkencore, politike, kulturore etj. Të gjitha këto zhvillime ndikuan pozitivisht në ngritjen e vetëdijes kombëtare, mirëpo Kosova mbi të gjitha synonte si më të rëndësishme të ishte republikë e barabartë e federatës jugosllave (V. Krasniqi 2009).

Populli shqiptar i Kosovës u ngrit në demonstrata, që rrjedhimisht shpërthyen në vitin 1981 nga studentët e Universitetit të Prishtinës. Marshimi i studentëve tuboi rreth 500 veta, e më pas për t’u bashkangjitur rreth 4.000 të tjerë. Parulla e demonstratave fillimisht ishte “Kushte më të mira” ndërsa më pas edhe me parulla politike si “Kosova-Republikë”. Në përleshje me policinë u vranë rreth 11 demonstrues, ndërsa sipas disa burimeve të shqiptarëve numri i të vvarëve kishte arritur deri në qindra. Kështu, ndëshkimet nga pushteti qendor jugosllav filluan duke nisur me burgosje, vrasje, keqtrajtme, diferencime, largime nga puna etj (V. Krasniqi 2009: f. 19).

Serbët nuk ndaluan me synimin e tyre për ndryshimin e kushtetutës që çonin drejt suspendimit të autonomisë së Kosovës. Përpyekja e fundit për ta shpëtuar suspendimin e autonomisë u bë nga minatorët e Trepçës ku rreth 1.350 veta u ngujuan me grevë në galeritë e thella nëntokësore. Duke mos pasur sukses as nga kjo përpyekje, u suspendua autonomia e Kosovës dhe u shpall gjendje e jashtëzakonshme. Shqiptarët e Kosovës reagues kundër këtij veprimi duke u ndeshur me policinë serbe. Si pasojë e kësaj u vranë rreth 100 veta, ndërsa nga mos ndalimi i

përpjekjeve për heqjen e shtettrrethimit, përsëri organet pushtuese u kundërpërgjigjen me dhunë duke pasur të plagosur, të vdekur si dhe helmime të nxënësve me gazra toksike, ku përveç të rinjëve, në mesin e tyre kishte edhe foshnje në entet parashkollore.

Si shkak i kësaj e pësoi edhe RSFJ, e cila pasoi me shpërbërjen e saj. Preludi i shpërbërjes së RSFJ-së fillimin e ka në Kosovë. Shkaku i kësaj shpërbërjeje nuk janë demonstratat e vitit 1981, pse shqiptarët kërkuan Republikë, por pse politika jugosllave i mbylli të gjitha shtigjet e dialogut me shqiptarët, i shpalli “armiqësore”, “nacionaliste” dhe “kundërrevolucionare” çdo të drejtë të shqiptarëve për liri, dinjitet, barazi, demokraci dhe Republikë. U mobilizuan “masat shqiptare”, veçanërisht punonjësit e ndërmartjeve të mëdha si Trepça, si dhe studentët e universitetit. Udhëheqja serbe ra nga qielli në tokë dhe kështu Jugosllavia u shpërbë si rezultat i trazirave dhe konflikteve politike në fillimet e viteve 1980 (Meier 2006: f.127).

Në fillimet e vitit 1990 filloi një zbutje nga ana serbe për shkak se dhuna e tyre ra në sytë e medias ndërkombëtare. Zbutja filloi nga lirimi i 108 të burgosurve politik nga burgjet e Serbisë, po ashtu u hoq edhe gjendja e jashtëzakonshme. Me këto rrethana shqiptarët e Kosovës formuan parti politike ku një ndër to ishte LDK e udhëhequr nga Dr. Ibrahim Rugova. Sa i përket kësaj periudhe, mund të themi se u mbyll një kapitull i hidhur për Kosovën mirëpo, më pas vazhdoi me një kapitull tjetër edhe më tragjik.

1.1. Përjetimet e një të afërmi gjatë periudhës së ish-Jugosllavisë

Referuar nga përjetimet e njerëzve gjatë kësaj periudhe, (majde dhe shumë të afërm), të cilët janë në gjendje të flasin me ditë apo javë të tëra për ngjarjet e përjetuara nga serbët. Nazmi Talla shkruan për të birin në librin e tij të kujtimeve “Kronikë e një vrasjeje” i botuar në vitin 2009. *“Më 2 shkurt 2021, bëhen 31 vjet që nga humbja e Fadil Tallës i cili kishte rënë nga plumbat e pushtuesve. Fadili ishte fëmija i parë nga shtatë fëmijët e Nazmi Tallës të cilët vinin nga Podujeva. Ai u shkollua, u edukua dhe si pjesë e edukatës së tij familjare kishte edhe dashurinë për atdheun. Ai ishte në gjendje të sakrifikoje çdo gjë, madje edhe jetën e tij për vendin e tij”* (Talla 2009).

Lidhur me demonstratat e vitit 1989, si dhe vrasje të tjera gjatë atij viti tek Fadili lanë gjurmë të thella. Në vitin 1990, kur rrugët e Besianës u vërshuan nga demonstruesit, grupet speciale të forcave policore serbe ushtruan dhunë mbi demonstruesit. Qëllimi i pushtuesve ishte të ushqeheshin me gjakun e të rinjëve shqiptarë. Më 1 shkurt 1990, njësia tankiste e Komandës

së Korparmatës së Nishit, nën komandën e kolonel Milan Koturit defiloi rrugëve të qytetit të Podujevës. Pikat e stacionimit të tyre ishin rruga Podujevë-Batllavë dhe Obranxhë-Llaushë (Talla 2009).

Sipas Nazmi Tallës ishin dhënë urdhëra, se kush duhej të vritej e kush të goditej. Kështu, Fadili 25 vjeçar me të dalë nga shtëpia e tij, saktësisht në rrugën kryesore, në Podujevë u vra nga oficeri serb Vishnjevac me urdhër të kolonelit serb, për një mësymje ushtarake në këtë zonë. Vrasja e tij ishte vrasja e parë publike që ndodhi në Kosovë. Kjo humbje u përjetua shumë si nga familjarët, poashtu edhe nga gjithë tjerët. Vlen të përmendet poashtu edhe varrimi i të ndjerit, i cili u bë me 2 shkurt 1990, dhe në të cilin morën pjesë rreth 80 mijë veta. Të gjithë ata, të rrezikuar për jetët e tyre, në ankth se mos ndodhte ndonjë gjë, pasi që jo vetëm gjatë varrimit, por të gjitha hyrjet-daljet ishin të rrethuara nga forcat serbe. Sikur të mos mjaftonte kjo, një muaj pas vdekjes së Fadil Tallës u helmuan nxënësit e shkollës nga e njëjta ushtri që vrau Fadilin. Në mesin e qindra nxënës të helmuar ishin edhe fëmijët e Nazmi Tallës apo motra dhe vëllau i Fadilit (Talla 2009).

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Për realizimin e këtij punimi janë shfrytëzuar literaturë parësore si dhe burime dytësore, që kanë mundësuar pasurimin e këtij punimi jo vetëm me literaturë të botuar por edhe më përjetime të individëve pjesëtarë në këtë konflikt. Këto përjetime, që ende mbeten të pashkruara, përbëjnë dëshmi okulare të dejateve të paditura që kanë shoqëruar jetën e shqiptarëve të Kosovës gjatë kësaj periudhe. Me qëllimin për të kryer një ndërthurje të të dhënave në literaturën e botuar me ato, të pabotuara ende, ky punim synon të përmbushë qëllimin e tij për një pasqyrim sa më të gjerë të konfliktit serbo-kosovar. Duke u përdorur literaturë nga burime të ndryshme, është bërë e mundur që punimi të shtjellohet sa më rrjedhshëm dhe në mënyrë sa më të qartë. Gjishtashtu punimi është pasuruar dhe me literaturë të autorëve të huaj, me qëllim për t'i bashkangjitur një këndvështrim të tretë.

2.1.1. Çështja e Kosovës 1990-1999

Nuk është aspak lehtë të shkruhet, apo të flitet për këtë temë. Është qartë tashmë se nga të gjitha ngjarjet apo rastet e dhimbshme pasojnë edhe problemet e tanishme. Duke qenë e pushtuar për rreth 10 vite nga Serbia e Millosheviqit, Kosova ka treguar rezistencë të fortë me përballjen e saj kundrejt pushtuesve.

Që prej momentit të shpërbërjes së Jugosllavisë, një sërë parimesh dhe normash që konsiderohen të rëndësishme për ruajtjen e rendit ndërkombëtar dhe paqen duket se kanë ndikuar politikën dhe masat e aplikuara nga diplomacia ndërkombëtare ndaj çështjes dhe më vonë pavarësisë së Kosovës. Shkaqet e brendshme të konfliktit duket se janë lënë në plan të dytë në kuptimin dhe trajtimin e rastit të Kosovës. Zgjidhjet e ofruara nga diplomacia ndërkombëtare u sfiduan nga konflikti për vetëvendosje në Kosovë. Praktikën e ndjekur në rastin e shpërbërjes së Jugosllavisë treguan se diplomacia ndërkombëtare rezultoi e pasuksesshme në përpjekjen e saj për të prodhuar konsensus midis palëve në konflikt, ajo pati një ndikim të ndjeshëm në përshkallëzimin e konfliktit midis serbëve dhe shqiptarëve (Abazi 2012). Përpara fillimit të luftës, rol të rëndësishëm në rastin e Kosovës luajtën Konferenca mbi Jugosllavinë dhe Komisioni Badinter, i cili negocioi shpërbërjen e Jugosllavisë; Marrëveshja në Dayton që i dha fund luftës së Bosnjës; Bisedimet në Rambouillet (Rambuqe) midis serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës me ndërmjetësinë e diplomacisë ndërkombëtare për gjetjen e një zgjidhjeje për statusin e Kosovës (Abazi 2012: f. 3-4).

2.1.2. Konferenca e paqes dhe Komisioni Badinter (1991-1995)

Zhvillimet shoqërore, politike dhe ato kombëtare në Kosovë pikërisht në këtë dekadë pasqyrojnë fuqishëm dhe drejtpërdrejtë një ndër dekadat vendimtare për Kosovën, epoka e cila përshpejtoi rrethanat historike, politike, kombëtare. Kjo dekadë është vazhdim, përjetësim i ri i aspiratës së atdhetarisë dhe të qëndresës shqiptare me idealin e çlirimit të Kosovës nga sundimi serb/jugosllav (*Krasniqi 2011: f.7*).

Konferenca e Paqes mbi Jugosllavinë, organizuar në gusht të vitit 1991 themeloi Misionin e Komunitetit European të Monitorimit dhe Komisionin e Arbitrazhit, i njohur ndryshe si Komisioni Badinter, me autoritet për të negociuar zgjidhjet e mundshme në kuadrin e shpërbërjes së Jugosllavisë. Konferenca u ofrua si forum për diskutimin e një kompromisi midis Republikave që kërkonin mëvetësinë nga Federata Jugosllave (*Abazi 2012*). Çështjet kryesore, me të cilat u mor Komisioni, siç edhe përkufizohet nga Alain Pellet, ishin përcaktimi “i qëllimit të parimit të vetëvendosjes siç ishte tashmë zbatuar në kontekste të veçanta, veçanërisht në kuadrin e dekolonializmit; raporti i këtij parimi me një tjetër parim po aq të rëndësishëm e themelor siç është parimi i qëndrueshmërisë së kufijve; dhe së fundi roli që mund të luajë një organ ndërkombëtar arbitrimi në raste të tilla” (*Pellet 1992*).

Puna e Komisionit Badinter në lidhje me legjitimitetin ndërkombëtar ishte më pak legjitime. Madje disa studiues kanë shkuar aq larg sa të akuzojnë Komisionin Badinter si një bashkëfajtor të drejtpërdrejtë dhe shkak kryesor për shpërbërjen e Jugosllavisë dhe të tragjedisë jugosllave (*Hasani 2003: f. 239*). Ndërkohë që zhvilloheshin luftimet, qëllimi i KE-së ishte rregulli dhe stabiliteti, duke frenuar konfliktin, për të gjetur një zgjidhje politike të krizës jugosllave. Në rastin e shpërbërjes së Jugosllavisë çështja e vetëvendosjes u trajtua në funksion të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ashtu si parashkruhet në konventat ndërkombëtare, të cilat duhet të garantoheshin pa vënë në dyshim sovranitetin territorial të shtetit. Kështu, u formuluan "norma urdhëruese" që kërkonin respektimin e vlerave njerëzore e demokratike nga Republikat që kërkonin njohje ndërkombëtare. Një qasje e tillë synonte, siç edhe thuhet shprehimisht në Deklaratën e Komunitetit European mbi Jugosllavinë, datë 3 shtator 1991, miratuar nga Konferenca Evropiane e Paqes në Takimin e Jashtëzakonshëm Ministror në Hagë, “të siguronte një përmbushje paqësore të aspiratave konfliktuale të popujve jugosllavë” (*Abazi 2012*).

Dy dokumente kryesore që dolën nga Konferenca, janë Deklarata dhe Udhëzuesi për Njohjen Ndërkombëtare, të cilat u zbatuan nga Badinteri. Sipas këtyre dokumenteve u vendosën rregulla që favorizonin Republikat si shtete pasuese të Jugosllavisë, të mos ishin më nën kontrollin efektiv të qeverisë federative të Beogradit, duke lënë jashtë këtij diskutimi problemin e kombësive dhe grupeve të veçanta etnike. Kështu, nga fundi i vitit 1991, përveç Serbisë, Malit të Zi, Kosovës dhe Vojvodinës, pjesa tjetër e Jugosllavisë ishte pak a shumë nën kontrollin e autoriteteve të reja (Hasani 2003).

Në rastin e Kosovës, shqiptarët mund të synonin të realizonin njohjen e kombësisë së tyre, sikundër edhe të drejtat e tyre qytetare dhe politike brenda shtetit serb, që ndryshe u quajt vetëvendosje e brendshme. Kjo zgjidhje u ofrua për të gjithë grupet etnike brenda Republikave të Federatës Jugosllave. Të drejtat e shqiptarëve në Kosovë si dhe të grupeve të tjera etnike, serbëve në Krajinë (Kroaci) dhe hungarezëve në Vojvodinë (Serbi), do të mund të mbroheshin nëpërmjet mekanizmave kushtetues të negociuara në nivel ndërkombëtar. Në funksion të një zgjidhjeje të tillë, njohja e sovranitetit të Republikave të Jugosllavisë si shtete më vete u kushtëzua paraprakisht nëpërmjet kërkesës që "*Republikat duhet t'u garantojnë anëtarëve të pakicave dhe grupeve etnike, të gjitha të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të njohura nga ligji ndërkombëtar, duke përfshirë, kur shihej e përshtatshme, të drejtën e kombësisë së tyre*" (Abazi 2012: f. 193-194).

Kufizimet dhe subjektet që lidhen me vetëvendosjen, kuptohen më së miri me anën e institucionit të ashtuquajtur *uti possidetis juris* (respektim i kufijve ekzistues në momentin e pavarësisë), i cili vë në dukje shpëputjen e konceptit të kombësisë prej atij të territorit. Duke rivendosur vetëvendosjen bazuar mbi territoret administrative të ish-republikave jugosllave, Komisioni Badinter la të kuptohej se e drejta për t'u shpëputur ndryshonte dhe varej nga shkalla e autonomisë së njohur prej qeverisë qendrore. Meqë përbërja dhe funksionimi i organeve kryesore të federatës jugosllave nuk i përmbushte më 'kërkesat e pjesëmarrjes dhe të përfaqësimit', komisioni arriti në përfundim se 'RSFJ është futur në procesin e shpërbërjes' (Hasani 2003: f. 248).

Kjo u bë më e dukshme kur Komisioni Badinter shpalli se shpërbërja e RSFJ-së ishte plotësuar dhe se RSFJ-ja nuk ekzistonte më, sepse ekzistenca e një shteti federativ, i cili është formuar nga disa entitete të veçanta, komprometohet, kur shumica e këtyre entiteteve, që kanë një pjesë të madhe të territorit dhe popullsisë, qëndrojnë më vete si shtete të pavarura e sovrane dhe si pasojë, pushteti federativ nuk mund të ushtrohet më në mënyrë efektive.

Rasti i Jugosllavisë i dha një funksionim pozitiv parimit të ashtuquajtur *utti possidetis juris*. Në thelb aty përfshiheshin luftëra për territorin, ndërsa në këtë rast u përfshi një përpjekje për t'i zbutur dhe kontrolluar këto luftëra. Komisioni Badinter theksoi qartë se vetëm nëpërmjet njohjes ndërkombëtare të ish-kufijve administrativ si kufij ndërkombëtarë, mund të shmangen konfliktet dhe luftërat për territore (Hasani 2003). Në dokumentin "Letra e Qeverisë së Republikës së Kosovës drejtuar Mbledhjes së Jashtëzakonshme Ministrore të Komitetit Politik European (EPC) në Bruksel, 21 dhjetor 1991", udhëheqja e shqiptarëve të Kosovës argumentoi se, brenda kuadrit të Kushtetutës së vitit 1974, Kosova gëzonte të drejta të barabarta përfaqësimi në nivelin federal me Republikat e tjera, ndonëse kishte statusin e një Krahine Autonome. Duke u bazuar mbi këtë argument u kërkua që Kosova të konsiderohej ashtu si Republikat e tjera, një njësi përbërëse e Federatës Jugosllave. Me gjithë kërkesën e udhëheqjes së shqiptarëve, Komisioni Badinter vendosi të mos e pajisë me sovranitet Kosovën, pasi raste të tilla të ngjashme nuk u negociuan në kuadrin e shpërbërjes së Jugosllavisë as në rastin e Republikave të tjera.¹

Një vendim i tillë nga Komisioni Badinter, i mohoi Kosovës të drejtën e vetvendosjes. Kështu, çështja e Kosovës mbeti nën kujdestarinë e Republikës së Serbisë. Zgjidhja formale e propozuar nga Komisioni për rregullimin e marrëdhënieve midis serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës në kuadrin e Republikës së Serbisë nuk mbante parasysh realitetin e këtyre raporteve që ishin përkeqësuar. Prej kohësh përgjigjja e regjimit të Milosheviçit ndaj të drejtave të shqiptarëve në Kosovë ishte dhuna dhe represioni i vazhdueshëm që përvijoi me heqjen e autonomisë së fituar me Kushtetutën Jugosllave të vitit 1974. Këto politika kishin sjellë për pasojë edhe përshkallëzimin me ç'rast Milosheviçi do t'u premtonte serbëve të Kosovës se "askush nuk do t'i keqtrajtonte ata" dhe kjo shënoi dhe fillimin e serbizimit të Kosovës dhe në të njëjtën kohë fillimin e një periudhe tepër të rëndë për shqiptarët të cilët jo vetëm po trajtoheshin si qytetarë të rendit të dytë, por edhe po u nënshtroheshin torturave sistematike nga regjimi serb (Abazi 2012).

Duke bojkotuar tërësisht sistemin serb, shqiptarët e Kosovës arritën ta vinin Serbinë në sytë e ndërkombëtarëve në pozitën e forcës pushtuese. Me qëllim që të kanalizonin politikën e tyre paqësore (1990-1997), shqiptarët e Kosovës përdorën politikën e institucioneve paralele *vis-a-vis* atyre të instaluar nga regjimi i Beogradit. Hapi i parë në këtë drejtim ishte hedhur më 2

korrik 1990, kur Kuvendi i Kosovës, një organ i ligjshëm sipas kushtetutës jugosllave 1974, e shpalli Kosovën njësi të barabartë dhe të pavarur brenda federatës jugosllave (Abazi 2012). Reagimi i regjimit të Beogradit ishte brutal. Ai e bllokoi Kuvendin e Kosovës, i cili u mbledh në fshehtësi dhe vazhdoi punën e vet pa deputetët serb e malazezë. Kuvendi bëri një hap më tej duke e shpallur Kosovën republikë federative brenda Jugosllavisë dhe pas kësaj shpalli synimin për të mbajtur një referendum për pavarësinë (Hasani 2003: f. 217).

Të gjitha këto akte kushtetuese nuk u përlligjën nga Komisioni Badinter. Me vendimet e tij, Komisioni Badinter nuk mori parasysh jo vetëm pavarësinë e vetëdeklaruar dhe kërkesat e udhëheqjes së shqiptarëve të Kosovës për t'u konsideruar si një entitet i barabartë me Republikat e tjera të Jugosllavisë, por edhe situatën e rënduar konfliktuale në terren që tashmë i kishte tejkaluar parimet e propozimeve të tij. Beogradi e shihte rastin e Kosovës si një çështje të brendshme të shtetit serb, që në asnjë mënyrë nuk duhej të ndërkombëtarizohej.

Vendimet e Komisionit, ndonëse jo në mënyrë të qëllimshme, forconin pozitat e serbëve të cilët ishin tashmë përgjegjës të vetëm për respektimin e vetëqeverisjes së brendshme të grupeve etnike madje dhe njohjes së kombësisë së tyre brenda Republikës Serbe që pak gjasa kishin që të viheshin në jetë nga regjimi i Milosheviçit. Ndaj në momentin që vendimet e Komisionit Badinter u bënë të qarta, një "rezistencë civile" e organizuar dhe jo e dhunshme filloi nga shqiptarët e Kosovës në mbrojtje të së drejtës së tyre për vetëvendosje jashtë kuadrit të Serbisë. Kjo u shoqërua me përshkallëzimin e ushtrimit të dhunës dhe shtypjes ndaj shqiptarëve të Kosovës. Në thelb të këtyre politikave ishte përjashtimi i shqiptarëve nga gjithë aktiviteti ekonomik, publik, politik e kulturor në Kosovë. Në kushtet e mungesës së punësimit, shërbimit shëndetësor, arsimimit e informimit në gjuhën amtare e jetës kulturore pritej që të vihej në rrezik vetë mbijetesa e shqiptarëve në Kosovë (Abazi 2012: f. 199).

Pushteti serb, që nga viti 1990 nxori një mori ligjesh dhe akte kundërkushtetuese, me të cilat rrënoi subjektivitetin politik të Kosovës. Numri i këtyre akteve tejkalon mbi 1000 akte kundërkushtetuese. Kuvendi i Serbisë ka aplikuar masat e dhunshme në ndërmarrjet ekonomike dhe në institucionet e tjera në Kosovë, duke bërë emërime dhe shkarkime kundërkushtetuese të kuadrit udhëheqës shqiptar të të gjitha llojeve duke filluar nga çerdhet e fëmijëve e Kryqi i Kuq e deri te Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës dhe organizatat e tjera shoqërore e humanitare të cilat nuk u kursyen nga këto masa të Serbisë (Këpuska 2004). Përgjigjja e shqiptarëve të Kosovës ndaj vendimeve të Konferencës, ishte organizimi i një rezistence

paqësore, me ç'rast tërhoqi vëmendjen e diplomacisë ndërkombëtare. Mirëpo, as serbët, as shqiptarët, nuk punuan për zgjidhje të përbashkëta. Kështu, në këtë tablo mungonte vetëm lufta.

Siç shihet edhe nga ky shtjellim, Komisioni i Badinterit mohonte qartazi kufijtë e Kosovës. Madje, po të mbështesnin opinionet e Komisionit, mendoj se Kosova nuk do të shpallej e pavarur. Duke u konsideruar të mbrojtur vetëm kufijtë republikanë, Kosova përmbante një diasavantazh mjaft të madh, gjë që nuk lejonte atë të përparonte, që ishte konsiderimi i saj si një pjesë e Serbisë.

2.1.3. Marrëveshja në Dayton (1995-1998)

Para se të analizojmë thelbin e Marrëveshjes së Dayton-it, vlen të theksohet se si u shtjelluan ngjarjet deri tek nënshkrimi i marrëveshjes. Përsëri ishte Serbia ajo e cila përbënte problemet kryesore të ngjarjeve. Menjëherë pas spastrimit etnik të Kosovës, pasoi agresioni serb i intensitetit më të lartë ku filloi me ndarjen e Sllovenisë (1990-1991), më pas me Kroacinë, të cilët agresorët serbë brenda një kohe relativisht të shkurtër i'a pushtuan gati dy të tretat e territorit (1991), pastaj me agresionin në Bosnjë e Hercegovinë (1992-1996) për të cilën do të shtjellohet pikërisht tani dhe në fund me luftën për pastrimin etnik të Kosovës për të cilën do të shtjellohet më poshtë.

Krijimi i etniteteve serbe në Bosnjë-Hercegovinë ka qenë një proces i koordinuar, që përfshinte jo vetëm territorin e kësaj republike, por edhe pjesë të mëdha të Kroacisë. Krijimi i këtyre etniteteve u lidh me ndryshimet kushtetuese që u bënë në Bosnjë-Hercegovinë. Këto ndryshime u bënë me qëllimin e rajonizimit të kësaj republike, që ta mundësonte atë të bëhej një shtet modern europian. Shumë kohë para se të fillonte lufta ishte e bërë e qartë se serbët nuk kishin për qëllim ta mbështesnin konceptin e tyre për rajonizim mbi kritere ekonomike apo sociale, por vetëm mbi parimin etnik (*Hasani 2003: f. 210*).

Serbia synonte copëtimin e shtetit të Bosnjë-Hercegovinës, duke i dhënë formën e një shoqate të quajtur “bashkësia e komunave *Bosanska Krajina*”. Gjithsesi, deri në shpërthimin e luftës së hapur në Bosnjë-Hercegovinë, udhëheqësit serbë e mbështetën retorikën e tyre në variantin e “qëndrimit brenda Jugosllavisë”. Në fakt, siç është vënë në dukje, Jugosllavia nuk kishte asnjë kuptim tjetër për serbët, përveç se që ishte një federatë e kontrolluar nga serbët. Nëse kjo nuk arrihej, atëherë vinte realizimi i hapur i projektit për Serbinë e Madhe (ideja e krijimit të një shteti serb që do të përfshinte territore të vendeve fqinje të Serbisë apo ndryshe bashkimi i të

gjithë serbëve në një shtet të vetëm). Duke e parë nga ky këndvështrim, ishte e qartë se projekti i Serbisë së Madhe nuk mund të realizohej me mjete paqësore (*Hasani 2003*).

Serbia kërcënonte hapur se do të shpallnin pavarësinë e tyre, në rast se edhe Bosnjë-Hercegovina do bënte të njëjtën gjë dhe kjo gjë u bë pikërisht ashtu siç u tha. Serbët shpallën “pavarësinë e republikës” së tyre dhe brenda pak muajve, serbët arritën të spastronin etnikisht gati 70% të territorit të Bosnjë-Hercegovinës duke siguruar në këtë mënyrë bazën territoriale për “shtetin” e tyre të ri.

Kështu, me të gjitha këto ngjarje që po ndodhnin, SHBA e kuptuan që të gjitha përpjekjet për ndalimin e tyre nga BE apo Kombet e Bashkuara nuk do të kishin sukses nëse nuk merrnin përsipër procesin e negociatave. Në këtë rast u nënshkrua marrëveshja e paqes ndërmjet dy palëve më 21 nëntor 1995, ndërsa zyrtarisht kjo marrëveshje u nënshkrua në një ceremoni në Paris më 14 dhjetor 1995. Dokumenti përfshinte se si do të ruhej paqja, përfshinte aspekte ushtarake, stabilizimin rajonal, kushtetutën, kufijtë ndër-entitar, refugjatët e të tjerë. Mirëpo, rastin e Kosovës nuk e mori në konsideratë as kjo marrëveshje pasi që Milosheviçi ishte prezent si përfaqësues i njëres prej palëve ndërmjetësuese të kompromisit të paqes si dhe në Kosovë nuk kishte ende luftë prandaj nuk ndihej nevoja që të merreshin me këtë çështje.

Kosova nuk u ftua në tryezën e negociatave dhe çështja e saj u përmend vetëm në rastin e plotësimit të parakushteve me qëllim për heqjen e "embargos së jashtme" mbi entitetin që kishte mbetur nga ish Federata Jugosllave, Serbia dhe Mali i Zi. Sikur të mos mjaftonte e gjitha kjo, Millosheviqi nuk u fajësua për politikën e tij të ashpër me implikime serioze ndaj të drejtave të njeriut në Kosovë. Përkundrazi, ai u vlerësua si një paqebërës dhe garantues i Marrëveshjes Dayton, e cila bëri të qartë se Kosova është një çështje e politikave të brendshme të Jugosllavisë. Lidërshipi politik serb duke përfshirë edhe opozitën, favorizonuan ruajtjen dhe forcimin e Republikës së Serbisë, si entitet unitar dhe njësi themeluese e Federatës së re Jugosllave. Edhe opozita e kryesuar nga Vuk Draskovic, President i Partisë Rilindja Serbe, kundërshtonte hapur idenë që Kosova të bëhej një njësi më vete brenda Jugosllavisë, krahas Serbisë dhe Malit të Zi (*Abazi 2012*).

Ndërkohë, diplomacia ndërkombëtare kërkonte përmirësimin e gjendjes së të drejtave të njeriut në Kosovë, duke i dhënë fund atmosferës shtypëse apo ndryshe të themi se nënkuptonte njohjen e të drejtës së shqiptarëve në Kosovë për vetëvendosje të brendshme e cila do të inkurajonte shpresat e tyre për vetëqeverisje. Pas Marrëveshjes së Daytonit, Ibrahim Rugova, presidenti i Republikës së Kosovës së vetëshpallur, vazhdoi me politikën e tij paqësore të negociatave,

vazhdoi të mbante kursin e politikës paqësore, e cila shkonte krah për krah me faktin se asokohe popullsia shqiptare e Kosovës qe thujse krejtësisht e paarmatosur, si edhe me faktin se asokohe Shqipëria nuk jepte shenja përfshirjeje si palë konflikti në Kosovë (*Ahrens 2010*). Me ndërmjetësimin e urdhërit Sant'Egidio të besimit katolik me bazë në Romë, u bë progres në zhvillimin e një agjende për reformën arsimore. Kjo përpjekje përfundoi me nënshkrimin e një marrëveshjeje midis Millosheviçit dhe Rugovës, në 1 shtator 1996, mbi rifutjen e gjuhës shqipe në sistemin arsimor të Kosovës (*Abazi 2012: f. 203*).

Të drejtat e njeriut në Kosovë jo vetëm që nuk patën ndonjë përmirësim, mirëpo vetëm sa u përkeqësuan duke pasuar edhe dhunime të të drejtave. Kështu, Këshilli i Mbrojtjes së Lirive dhe të Drejtave të Njeriut në Prishtinë, raportonte se vetëm në muajin mars 1996, ishin keqtrajtuar dhe torturuar 839 shqiptarë nga policia serbe. Në muajin shkurt 1996, vlerësohej të kishte më shumë se 250 raste. Gjatë muajit prill, ishin keqtrajtuar 711 shqiptarë. Vetëm në komunën Stimlje, ishin keqtrajtuar 122 persona, 116 familje u ishte bërë kontroll dhe 129 persona ishin thirrur për të dëshmuar në rajonin e policisë. Dhunimet e të drejtave të njeriut, nga ana e autoriteteve serbe kundër shqiptarëve të Kosovës pas Marrëveshjes në Dejton, u raportuan në seancën e 52-të të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut.²

Duke u parë nga ky këndvështrim, lufta ishte mjeti i vetëm për arritjen e qëllimeve. Duke u përballur me këto zhvillime, në shkurt 1996 UÇK kishte filluar me sulmet e para kundër stacioneve policore dhe përfaqësuesve të Jugosllavisë së cunuar, kështu që qeveria e Beogradit shtoi numrin e forcave të saj të sigurisë në Kosovë. Në prill 1996, UÇK-ja bëri lëvizjen e saj të parë, duke vepruar në katër vende të ndryshme: Pejë, Stimlje, Deçan dhe në rrugën Kosovë-Mitrovicë- Pejë, ku u vranë 5 serbë. Grupi ushtarak lajmëroi se veprime të tilla do të ishin një paralajmërim për botën pasi që ata mbështesnin agresorët serb, ndërkohë që shpërfillej vullneti i popullit të shtypur të Kosovës.

Jo vetëm nga pikëpamja e Beogradit, por edhe ajo amerikane, UÇK u bë organizatë terroriste. Ajo përbëhej prej grupeve të ndryshme, rivalizuese me njëra-tjetrën, anëtarët e së cilës rekrutoheshin prej strukturave klanore dhe familjare apo lojaliteteve lokale. Thuhet se për financimin e saj UÇK ishte involvuar edhe në tregtinë me drogë. Shkatërrimi i rendit publik në shtetin fqinj, në Shqipëri, si pasojë e skandalit të piramidave të vitit 1997 i dha gueriles

kosovare një shans të mirëseardhur të pajiset lirë me armë, t'i ushtrojë luftëtarët e saj në kampe të Shqipërisë veriore dhe në garë me regjimin e Beogradit të sjellë më tutje spiralen e dhunës (Rafael Biermann 2006).

Duke e parë nga ky këndvështrim, shihet qartë se as kjo marrëveshje nuk ishte në favor të Kosovës. Dokumenti i cili përmbante se si duhej të ruhej paqja, nuk rezultoi ta merrte në konsideratë rastin e Kosovës, përkundrazi të drejtat e njeriut u dhunuan. Në këtë gjykim, kjo marrëveshje jo vetëm që nuk ishte e drejtë, por ajo ndëshkoi të sulmuarit duke vlerësuar agresorët.

2.2. Shpërthimi i luftës në Kosovë

Lufta e Kosovës ishte një konflikt i armatosur i cili filloi në muajin shkurt të vitit 1998 nga agresioni serb. Pushtuesit serb filluan ofensivën në Drenicë kundër popullatës së paarmatosur dhe të pa mbrojtur me pretekst se shqiptarët nuk po e njohin shtetin serb dhe se operacionet i kishin drejtuar gjoja kundër “bandave terroriste shqiptare”. Kur populli shqiptar filloi të mbronte vatrat e veta dhe kur doli në skenë Ushtria Çlirimtare e Kosovës me armë në dorë si mbrojtëse e popullit dhe e trojeve të veta shekullore, atëherë u “sensibilizuan” organizmat ndërkombëtarë dhe u pa se çështja e Kosovës nuk është çështje e brendshme e Serbisë, por çështje e jetës ose vdekjes e një populli të lashtë autokton të Evropës (Këpuska 2004).

Kur Serbia filloi sulmin mbi fshatrat shqiptare të Drenicës, përkatësisht në fshatin Likoshan, u vranë dhe u masakruan 16 shqiptarë. Në këtë operacion serbët përdorën helikopterë dhe automjete të blinduar. Disa ditë më vonë, përkatësisht me 5 mars, për të vazhduar edhe më 6 e 7 mars, Prekazi u rrethua nga policia serbe për herë të tretë pasi që ai u rrethua edhe dy herë të tjera. Policia serbe ishte aty edhe më 22 janar 1998 duke u drejtuar në Kullën e Jasharëve, për ta sulmuar atë me armë të llojeve të ndryshme. Meqë atë natë Adem Jashari nuk ndodhej në shtëpi, rezistencë sulmit të policisë serbe i kishin bërë Shabani e Hamza, me nipa e mbesa, ku kishin marrë plagë disa anëtarë të familjes Jashari, ndërsa forcat e armikut ishin detyruar të tërhiqen. Mirëpo, me 5 mars filloi masakra e vërtetë ndaj familjes Jashari (V. Krasniqi 2009).

Pas një qëndrese titanike nga familja Jashari, pas tri ditë rresht qëndrese bien në altarin e lirisë mbi 50 dëshmorë, shumica prej të cilëve ishin gra dhe fëmijë. Vrasja e familjes Jashari reflektoi thellë, duke prekur ndërgjegjen e gjithë shqiptarëve. Ngjarja në Prekaz shkaktoi një valë të re të shpërnguljeve të refugjatëve nga Drenica në vise të tjera të Kosovës. Në mars të këtij viti, Grupi i Kontaktit (SHBA, Rusi, Francë, Gjermani, Itali) i'u kërcënua Serbisë me një varg masash si psh. mosdhënia e vizave, bllokimi i kredive dhe investimeve nëse Millosheviqi nuk

e ndryshonte politikën e tij brenda dy javësh. Kur ky afat po skadonte, ai u vazhdua edhe për një muaj. Përgjigjja e vetme e Millosheviqit ishte zgjerimi i sulmeve mbi caqet e UÇK-së nëpër fshatra (V. Krasniqi 2009: f.37).

Më 24 mars, policia serbe sulmoi rajonin e Dukagjinit, përkatësisht fshatin Gillogjan. Pas këtyre luftimeve në rajonin e Drenicës e Dukagjinit, lufta filloi të përhapet me intensitet të lartë edhe në rajone tjera, si në Pashtrik (luftimet e Llapushnikut, Drenocit, Llatkocit) dhe në vazhdim në tërë zonën e Pashtrikut, pastaj luftimet vazhduan në rajonin e Shalës, Nerodimes, Llapit, Karadakut, kështu lufta u shtri në tërë Kosovën. Forcat serbe për aq sa mbërrinin nëpër vendbanimet e popullatës, vrisnin, zbraznin, dhunonin, masakronin etj. Pra, qëllimi i tyre ishte spastrimi etnik dhe çrrënjësja e UÇK-së.³

Fuqitë e mëdha bënë përsëri përpjekje për të bërë presion mbi pushtetin jugosllav duke kërcënuar me sulme ajrore. Ndërsa, në tetor u arrit një marrëveshje mes emisarit amerikan Richard Holbrook dhe Millosheviqit me disa kushtëzime si psh. të zvoglohej numri i forcave serbe në Kosovë dhe të gjithë shqiptarët të mbeten nëpër shtëpitë e tyre, sigurisht duke qenë nën vëzhgimin e ndërkombëtarëve.

Ditët e fillimit të vitit 1999 treguan me fuqinë e fakteve se kishte mbaruar armëpushimi. Pikërisht në këtë periudhë të një gjendjeje “as luftë, as paqe” ndodhi masakra e Raçakut. Ja si i paraqet ngjarjet aktakuza e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë kundër Millosheviqit: *“Në agimin e 15 janarit 1999 ose rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë nisën një ofensivë kundër fshatit Raçak. Pas granatimit të tij nga ana e njësisë VJ-së, policia serbe hyri më vonë gjatë paradites në fshat dhe ndërmori bastisje shtëpi më shtëpi. Kudo në fshat, fshatarët që përpiqeshin t’i iknin policisë serbe u vranë. Një grup prej rreth 25 burrash që orvateshin të fshiheshin në një ndërtesë, u zbuluan nga policia serbe. Këta burra u rrahën, pastaj u morën në drejtim të një kodre aty afër ku policët i ekzekutuan. Gjithsej, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vranë rreth 45 shqiptarë të Kosovës në Raçak e në rrethinat e tij”* (Metais 2006: f. 401).

Në atë kohë në terren ishte e pranishme OSBE, përmes një misioni. Ai ishte krijuar në vitin 1998 me qëllim të kontrollimit të zbatimit të rezolutës 1199 të OKB-së dhe të armëpushimit. Kreu i misionit, William Walker e akuzoi menjëherë Beogradin, pasi që e dinte se masakra nuk

ishite një “pasojë e pakëndshme” e paraushtarakëve. Poashtu, CIA i kishte dhënë të dëgjonte regjistrimet e bisedave telefonike mes zëvendëskryeministrit jugosllav Nikolla Sainoviç dhe gjeneralit Sreten Lukiç, në të cilat Nikolla udhëzonte Lukiçin, që të vepronte ashpërsisht në Raçak. Kjo masakër shënoi në të vërtetë dëbimin dhe shfarosjen e shqiptarëve (*Metais 2006*).

2.2.1. Konferenca e Rambouillet

Masakra e cila ndodhi në fshatin Raçak, ndikoi që të thirret një konferencë ndërkombëtare për Kosovën, e cila do të mbahej në Rambuje të Francës më 6 shkurt 1999. Grupi i Kontaktit prej 6 antarësh shprehu nevojën për mbledhjen e udhëheqësve serbë dhe shqiptarë. Bazë e këtyre bisedimeve ishte një propozim i njohur si plani i Hillit (Kristofer Hill, ish-ambasador amerikan në Maqedoni), i cili kishte bërë përpjekje edhe më parë për negociimin ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve. Këtij plani iu bashkangjitën Volfang Petriq dhe rusi Boris Majorski, ndërsa drejtues të bisedimeve ishin anglezi Robin Cook dhe francezi Hyber Vedrin. Pra, me fjalë tjera mund të themi se ky plan përmbante substancën e autonomisë së Kosovës (*V. Krasniqi 2009*).

Për të dy palët, serbe dhe shqiptare, faktori ndërkombëtar ushtronte presion. Palës serbe po i thuhej se, nëse nuk nënshkruan propozimet, do të bombardohet, ndërsa shqiptarëve u thuhej se, nëse nuk nënshkruanin do t’i linin në duart e serbëve. Delegacionin shqiptar e përbënin: UÇK-ja, kryesuese e delegacionit; LDK-ja dhe LBD-ja. Grupi i Kontaktit nuk lejonte një shqyrtim për pavarësinë e Kosovës. Adem Demaçi nuk lejonte të merrte pjesë në negociata duke konsideruar se aty nuk kishte çfarë të negociohej. Në këto rrethana, ai u detyrua të braktiste titullin e tij si zëdhënës i UÇK-së dhe kështu përgjegjësia e vendimit për pjesëmarrje i takoi Hashim Thaqit, i cili ishte i pranishëm në Rambuje (*Metais 2006*).

Madeleine Albright e cila u imponua shpejt në krye të Grupit të Kontaktit, ishte e mendimit se Kosova do të mbetej krahinë e RFJ-së mirëpo do të gëzonte një “autonomi substanciale”, do të mbaheshin zgjedhje demokratike për një “qeveri krahinore”, çështja e pavarësisë do të diskutohej vetëm në krye të tre vjetëve si dhe Kosova do të pushtohej nga forcat e NATO-s për garantimin e zbatimit të angazhimeve të marra (*Metais 2006*).

Jakup Krasniqi si zëdhënës i UÇK-së, konfirmonte shkuarjen në Rambouillet si dhe kishte përmendur emrat të cilët do të shkonin në emër të UÇK-së siç janë: Azem Sylja, komandant i përgjithshëm i UÇK-së, Xhavit Haliti, poashtu themelues i UÇK-së dhe përfaqësuesi i saj në Shqipëri, Hashim Thaqi, shef i Drejtoratit Politik, Ramë Buja, shef i Drejtoratit për Çështje Civile, dhe Jakup Krasniqi. Përveç këtyre, ishin edhe emra të njohur të partive politike të cilët

do të merrnin pjesë dhe së bashku me ta u bënë gjithsej 16 veta në delegacionin e Kosovës. Sa i përket delegacionit të Serbisë, ata pa diskutim që vendosën të marrin pjesë në Konferencë, pasi që mosshkuarja e tyre do të shpallte Beogradin si fajtor për dështimin e përpjekjeve të Grupit të Kontaktit për të zgjidhur çështjen e Kosovës (*Shala 2003: f.218*).

Kryesuesit e delegacionit të Serbisë ishin Ratko Markoviqi, zëvendëskryeministër serb, Vladimir Shtambuku, zyrtar i lartë, Nikola Shainoviqi zëvendëskryeministër federal, dhe Vlladan Kutleshiq zëvendëskryeministër në qeverinë federale. Të gjithë këta ishin miq të familjes Millosheviq – Markoviq (*Shala 2003: f.219*). Bisedimet në Rambuje zgjatën nga 6 deri më 23 shkurt 1999. Gjatë bisedimeve secila palë përpiqej të shmangte fajësimin për prishjen e bisedimeve dhe nuk mund të binin dakord. Për shkak të mos arritjes së marrveshjes në mes tyre në afatin e caktuar fillestar më 19 shkurt, ato u shtynë për një muaj. Parimet në këtë dokument ishin vetëqeverisje demokratike, paqe dhe siguri për cilindo, kujdes shëndetësor, arsimor dhe zhvillim ekonomik. Kosova do të kishte presidentin, kuvendin dhe gjykatat e saj (*Hasani 2003*).

Pas shumë ekzibicioneve e përpjekjeve, baticave e zbaticave, më 18 mars 1999, pala kosovare e nënshkroi marrëveshjen. Pavarësisht nga garancitë e dhëna për sovranitet dhe integritet territorial të RFJ-së, autoritetet e Beogradit nuk pranuan ta nënshkruajnë këtë dokument. Regjimi i Millosheviqit vazhdoi fushatën e tij luftarake në Kosovë, nisi ofensivën e madhe të spastrimit etnik duke dëbuar nga shtëpitë e tyre qindra mijëra shqiptarë. Nga frika prej akteve hakmarrëse serbe më shumë se 800'000 njerëz braktisën vendlindjen e tyre dhe shpëtuan kokën në Shqipëri dhe Maqedoni. Të nesërmen, sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Javier Solana, më 24 mars i filloi bombardimet mbi caqet e ushtrisë serbe në Kosovë dhe Serbi (*V. Krasniqi 2009*).

Ndër mbështetësit më të vendosur ishte kryeministri britanik Tony Blair. Ai ishte i mendimit se politika e nënshtrimit ndaj Millosheviqit kishte dështuar, se nuk duhej lejuar përsëritja e një "Bosnje të dytë. Nën presionin e Blair-it NATO vendosi të intervenojë. Madje pa mandat të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, pasi që Kina dhe Rusia, duke pasur parasysh problemet e tyre, nuk mbështetën një vendim të tillë.

Nga 24 marsi deri më 10 qershor 1999, për rreth 72 ditë bombardime, u kryen 2.300 sulme ajrore me ç'rast u hodhën 22 mijë tonë eksploziv kundër 8 caqeve në Serbi dhe 70 në Kosovë, gjithashtu u përdor edhe uranium i përzier. Gjatë kësaj kohe kishte luftime ndërmjet forcave serbe dhe UÇK-së. Me fjalë të tjera mund të themi se aleanca NATO-UÇK luftoi deri në

kapitulim përfundimtar të ushtrisë jugosllave. Sipas një përfundimi, që erdhi si pasojë e veprimeve serbe, rreth 800.000 shqiptarë civilë u dëbuan me dhunë nga Kosova, rreth 15.000 të vrarë e të masakruar, prej tyre 2.000 dëshmorë të UÇK-së, djegia e disa qindra mijëra shtëpive, grabitja e pasurisë etj (V. Krasniqi 2009: f. 40).

Milloseviqi më në fund u detyrua të dorëzohej. Forcat e armatosura serbe filluan të tërhiqeshin më 10 qershor 1999. Po këtë ditë, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi Rezolutën 1244 e cila parashikonte vendosjen e NATO-s për t'i bindur ushtrinë dhe policinë serbe të mos ktheheshin më në Kosovë. Kështu, Kosova u vendos nën administrimin e përkohshëm të OKB-së, territorri i së cilës drejtohet qysh nga viti 1999 nga një institucion i OKB-së, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), ndërsa KFOR ishte forca kryesore ushtarake e sigurisë (Metals 2006). Njëra ndër vështirësitë më të mëdha për KFOR-in ishte çarmatosja e UÇK-së, pasi që shihej si pjesë e marrëveshjes së Rambujesë. Për këtë arsye, më 21 qershor 1999 u lidh një marrëveshje ndërmjet UÇK-së dhe NATOS-s me qëllim të dorëzimit të të gjitha armëve të UÇK-së, derisa një pjesë e pjesëtarëve kaloi në TMK (Trupat Mbrojtëse të Kosovës).⁴

Pas përfundimit të luftës pasuan arratia dhe përndjekja e serbëve të Kosovës. Shkatërrimi i Jugosllavisë, i cili filloi me Kosovën në vitin 1989, pas dhjetë viteve plot vuajtje çoi në shkëputjen faktike të Kosovës nga Serbia. Kështu, sapo u kthyen refugjatët, Kosova iu përvesh punës duke mjekuar plagët që kishte marrë dhe filloi rindërtimin. Me ndihmë dhe me përpjekje për vendosjen e një demokracie pluraliste, e cila do të ndihmonte në drejtimin e vendit së bashku me nënpunësit ndërkombëtarë të UNMIK-ut dhe KFOR-it.

2.2.2. Familja ime gjatë luftës

Përjetimet e familjes time gjatë periudhës së luftës nuk ishin nga më të rëndat. Them kështu për arsye se më të rënda i konsideroj vrasjet apo masakrimet. Fatmirësisht, në familjen time nuk ka pasur të vrarë. Babai, nëna, motra dhe unë kemi qenë jashtë Kosovës mirëpo, ishin gjyshërit, ata të cilët e përjetuan luftën.

Gjatë gjithë kohës ata kanë qëndruar në shtëpinë e tyre në Prishtinë (Sofali), sigurisht të frikësuar pas gjithë ngjarjeve, që po ndodhnin me popullin e tyre. Ata veçse ishin në dijeni se

lufta do të shpërthente dhe kjo u vërtetua kur dëgjuan për sulmet në Drenicë. Ata nuk dinin se as çfarë të bënin, të lëvizin nga shtëpitë e tyre apo jo. Ditën kur NATO filloi bombardimet të gjitha shtëpitë po dridheshin ndërsa pas gjashtë ditëve nga bombardimet e NATO-s të gjitha shtëpitë u rrethuan nga serbët dhe u detyruan të iknin dhe të niseshin drejt pyllit. Ishin rreth 7.000 njerëz që ishin drejtuar pyllit dhe duke ecur, plumbat fluturonin mbi kokat e tyre.

Ashtu siç tregojnë edhe gjyshërit, Zejnullah Ferati dhe Mihrije Ferati: *“Ishim duke ecur me një grup njerëzish të drejtuar për në fshatin Mramor. Gjatë rrugës hasëm me kufomën e një të afërmi tonë, i masakruar nga forcat serbe. Ai kishte dalur për të prerë dru me sharrë dhe nuk ishte në dijeni për ngjarjet mirëpo, kur ne e gjetëm ai ishte masakruar me vetë sharrën e tij. Ne e varrosëm aty dhe më pas vazhduam rrugën tonë”*. Kur ata mbërrijnë në fshatin Mramor, hynë në një shkollë dhe aty qëndrojnë rreth tri javë. Mirëpo, pas tre javësh serbët mësojnë për vendndodhjen e tyre dhe ata u detyruan të iknin përsëri. Siç tregojnë gjyshërit, kush ka mundur të ikë ka shpëtuar, ndërsa kush nuk ka mundur i kanë vrarë. Pas ikjes ata përsëri u detyruan të ktheheshin në Prishtinë.

Duke vazhduar kështu Zejnullah Ferati tregon se çfarë ndodhi pas kthimit në Prishtinë... *“Duke mos guxuar të shkonim në lagjen tonë pasi që ishte e rrethuar nga serbët, ne shkuam në një lagje tjetër tek shtëpia e një të afërmi. Edhe aty nuk qëndruam gjatë. Mirëpo, aq sa qëndruam, 2 javë, nuk guxonim të lëshonim as edhe një dritë të vetme në mënyrë që të mos e kuptonin serbët se ka njerëz aty. Unë gjithashtu nuk kisha dijeni asgjë për vajzën time. Kështu, vendosa të dal dhe ta kërkoi vajzën në një vend ku kam dëgjuar se është strehuar. Unë shkova aty dhe e pashë vajzën time, mirëpo, kur u nisa të kthehem për në shtëpi, serbët më ndalën dhe më dërguan në një podrum të një shtëpie. Ata më thanë të vendosja në një tavolinë gjithçka çfarë kisha me vete. Unë me vete kisha 100 marka dhe kur ata panë paratë më thanë se “nëse paratë i merr përsëri me vete, atëherë do të dërgojmë në stacionin policor tek serbët”. Unë nuk i mora paratë, i lash aty. Kështu, shpëtova dhe u nisa për në shtëpi”*.

Gjyshi Zejnullah kujton dhe një përplasje tjetër me forcat serbe, ditën kur i është dashur të kthehet në shtëpinë e tij në Sofali, në të cilën jeta e tij ishte në rrezik. Aty janë përballur me forcat serbe, por fatmirësisht kanë mundur të shpëtojnë. Ditë më pas, serbët ndërmorën një ofensivë tjetër ushtarake në lagjen ku po qëndronin gjyshërit, që i detyroi banorët e lagjes të largoheshin. Me këtë rast, ata u nisën drejt stacionit të trenit në Fushë Kosovë. Ata hypën në trenin e fundit i cili ishte nisur për Maqedoni dhe atje qëndrojnë katër javë në shator. Në momentin që trupat e NATO-s hynë në Kosovë, ata nisen për në shtëpinë e tyre në Prishtinë.

Mirëpo, çfarë të shohin? Të gjitha shtëpitë ishin të djegura, të plaqkitura. Nuk kishte mbetur më asgjë, e gjitha ishte e shkatërruar. Nuk ishte vetëm lagjia e familjes time që ishte në gjendje të tmerrshme mirëpo, ishte i gjithë vendi i cili e kishte pësuar.⁵

2.3. Krimet e Luftës në Kosovë

Krimi i cili u zhvillua në Kosovë, krimi ndaj njerëzimit, e shkaktuan njësitet paramilitare dhe njësitë ushtarake e policore të Serbisë ndaj popullsisë së Kosovës. Viktimë e krimit të tillë ishte e tërë popullsia e Kosovës, të cilët kërkonin liri, jetë të pavarur dhe zhvillim burimor. Si pasojë e këtyre ngjarjeve, u prek qenësia e viktimave të të gjitha komunave të Kosovës, që u vranë, u masakruan dhe u zhdukën në format më të egra çnjerëzore. Krimet e luftës në Kosovë u pasuan me: vrasje, vrasje në masë, zhdukja e kufomave, varrezat masive, masakra, vrasje të grave dhe të fëmijëve, vrasje të burgosurve, vrasje të veprimtarëve politikë dhe humanitarë, vrasje të inskenuara, të humbur, të pagjetur dhe të zhdukur, përdhunime dhe abuzime seksuale, dëbime të dhunshme, shkatërrimi i pronësisë private dhe xhamive, grabitja dhe plaqkitja, minat tokësorë dhe shumë e shumë të tjera (*KMDLNJ 2010*).

Më shumë se 80% e tërë popullsisë së Kosovës – 90% e shqiptarëve u dëbuan nga shtëpitë e tyre. Askush nuk parashikoi shpejtësinë dhe shkallën e dëbimeve. Në përgjithësi, masakrat motivoheshin në tri mënyra. Së pari, t'i hapej rruga “spastrimit etnik” nëpërmjet kërcënimit e frikës. Së dyti, të vriteshin individë të dyshuar si luftëtarë apo si simpatizantë të UÇK-së. Së treti ishin vrasjet për hakmarrje: disa masakra u kryen pasi UÇK-ja kishte shkaktuar viktima ndër forcat serbe e jugosllave. Poashtu, ka dëshmi të padiskutueshme, sipas të cilave janë dhunuar varret e janë zhvendosur kufoma nga ana e trupave serbe e jugosllave. Përdhunimi e dhuna seksuale ishin gjithashtu elementë të fushatës. Sikur të mos iu mjaftonte e gjitha kjo, shqiptarëve gjithashtu u kishin zhvatur edhe gjëra të çmueshme, përfshirë unaza martesore dhe automobile.

2.3.1. Disa nga masakrat të paraqitura në tabela

KMDLNJ në Prishtinë përpiloi tekstin “KRIMET E LUFTËS NË KOSOVË 98'- 99' ”, Monografi. Kjo monografi për temë shqyrtimi ka krimin dhe përmasën gjenocidiale në Kosovë.

Tabelat e paraqitura më poshtë janë e drejtë e autorit nga kjo monografi. Kjo monografi ndryshon nga botimet e deritashme pasi që të dhënat dhe faktet mbi viktimat kanë karakter burimor, sepse u mblodhën drejtpërdrejtë nga familjet, farefisi, banorët e lagjeve, fshatrave dhe qyteteve të Kosovës, që patën fatin t’i mbijetojnë torturës së këtyre viteve.




Tabela 1. Numri i të vrarëve sipas komunave gjatë luftës në Kosovë

Në këtë tabelë është paraqitur numri i vrasjeve sipas komunave të Kosovës gjatë luftës së vitit 98’ – 99’, ku Skenderaji shënon numrin më të madh me 969 vrasje, ndërsa Novobërda shënon numrin më të vogël me 3 vrasje.




Tabela 2. *Struktura e të gjitha viktimave të vrara sipas moshës*

Në këtë tabelë është paraqitur struktura e viktimave të vrarë sipas moshës ku 3 prej tyre nuk janë të identifikuar.




Tabela 3. *Numri i varrezave masive sipas komunave*

Në këtë tabelë është paraqitur numri i varrezave masive të pazbuluara sipas komunave, ku Peja shënon numrin më të madh me 38 lokacione në të cilat janë zbuluar 428 persona të ekzekutuar të gjinive dhe moshave të ndryshme ndërsa në komunën e Gjilanit është identifikuar dhe hapur një varrezë masive me 6 persona të vrarë.




Tabela 4. Numri i rasteve të vrasjeve në masë sipas komunave

Në këtë tabelë është paraqitur numri i vrasjeve në masë sipas komunave, ku Gjakova shënon më së shumti raste me 693 persona të vrarë, ndërsa Istogu me numrin më të vogël të rasteve me 19 të vrarë.

Tabela 5. Të dhënat për të vrarët në të gjithë Kosovën 1998-1999

Kosovë	Civilë shqiptarë	Civil serbë	Të tjerë	N.N	Ushtarë të UÇK-së	Nga forcat serbe
11017	7900	281	30	3	1950	853

Tabela 6. Të dhënat për të zhdukur në të gjithë Kosovën 1998-1999

Gjithsej	Civilë shqiptarë	Civilë serbë	Të tjerë	Ushtarë dhe police serbë
1445	1277	123	21	24

3. DEKLARIMI I PROBLEMIT

Zgjodha pikërisht këtë temë për punimin tim sepse dëshiroj që të gjithë të mësojnë atë çka përjetoj vendi im përgjatë viteve. Edhe pse kanë kaluar më shumë se 21 vite që nga lufta e Kosovës, pasojat përsëri janë prezente. Duke mbetur shumë pyetje të hapura sa i përket kohës së luftës, rasti i Kosovës tërhoqi po ashtu edhe vëmendjen e opinionit lexues në botë të cilët vinin në përfundim se objektivi kryesor i palëve “ndërluftuese” ishte për të dëshmuar se e kujt ishte Kosova gjatë historisë.

4. METODOLOGJIA

Gjatë përgatitjes së këtij punimi janë përdorur metoda të ndryshme që kanë ndihmuar në realizimin e një punimi sa më të mirë, duke pasur një ide dhe koncept mbi kuptimin e çështjes së Kosovës në vitet 1990-1999. Përkatësisht, në këtë punim është përdorur metoda e analizës e cila konsiston në formulimin e problemeve të ndryshme duke vazhduar kështu deri tek shtjellimi i problemit. Poashtu, është përdorur edhe metoda e kërkimit doktrinar ku nëpërmjet kësaj metode është arritur të bëhet identifikimi, mbledhja dhe sistemimi i librave, monografive, studime shkencore të autorëve të ndryshëm. Gjithashtu janë shfrytëzuar dhe të dhëna të marra nga intervistat me dëshmitar okularë, që kanë asistuar në momente të rëndësishme. Përjetimet e kujtimet e tyre në ato momente janë përdorur për ta plotësuar këtë studim.

5. PËRFUNDIME

Që nga fillimi i Luftës së Dytë Botërore çështja e Kosovës ishte preokupim të thuash i të gjitha forcave të rëndësishme politike e ushtarake në Kosovë, në Shqipëri, në Jugosllavi, por edhe i disa shteteve të tjera ballkanike dhe evropiane, pa marrë parasysh a kishin ato orientim nazifashist apo kundër-nazifashist. Çështja e Kosovës ishte gurthemel i marrëdhënieve të popullit shqiptar me popujt e tjerë fqinjë, veçanërisht me popullin serb e malazet, që kishte përbërë synime pushtuese të cilat nuk i flaku as në rrethanat e asaj lufte. Mirëpo, mendoj se këtë të dhënë nuk e ditën apo nuk deshën ta dinin shumë prej forcave, prandaj çështja e Kosovës mbeti e pazgjidhur deri në ditët e sotme, si një pikë e rëndësishme të Ballkanit dhe Evropës. Përfundimisht nga i gjithi ky trajtim më lartë, dua të potencoj se Kosova që nga fillimi i saj ka pasur qëllimet dhe synimet për ti arritur, me gjithë pengesat e ndryshme gjatë rrugës së saj, duke qenë si kombi më i shtypur të cilit i mohohet e i nëpërkëmbeshin të gjitha të drejtat dhe liritë kombëtare e njerëzore. Për Serbinë, çështja e Kosovës ishte kyçe. Gati asnjë qytet dhe vend në Kosovë nuk i ka shpëtuar torturave masive të njëjësive ushtarake. Qëllimi ishte që shqiptarëve mos t'u lejohej vetëvendosja. Shumë njerëz u vranë dhe u zhdukën, të drejtat e popullit u zvogëluar, kurse kompetencat e organeve të pushtetit në Kosovë u pezulluan dhe u kaluan në duar të ushtrisë. Pas shumë krijimeve të konferencave, të marrëveshjeve, nuk mungoi asnjëherë shpresa se do të bëhej mirë për shqiptarët e Kosovës. Konferenca e Rambouillet ishte përpjekja e fundit për zgjidhje të ngjarjeve të cilat po ndodhnin, mirëpo, serbët nuk e nënshkruan marrëveshjen e cila ofronte kjo konferencë. Në vend që të bisedonin, serbët vazhduan regjimin ndaj shqiptarëve. Që do të thotë se statusi përfundimtar i Kosovës nuk u përcaktua në Marrëveshjen e Rambouillet. Si pasojë e kësaj, NATO u detyrua të bombardonte me sulme ajrore Serbinë. Duke ndjekur ndaj shqiptarëve në vazhdimësi politikë të luftës për dominim, për dëbim dhe shfarosje nga ana serbe, beteja vendimtare për çlirimin e Kosovës ishte lufta e popullit të Kosovës, me në krye Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Gjatë gjithë kësaj periudhe ndodhën demonstrata, shpërngulje, mashtrime, masakrime, abuzime, dhunime dhe deri tek më e fundit, zhdukje dhe vrasje. Rasti i Kosovës vazhdon të paraqesë interes të vecantë për studim të vazhdueshëm, pasi dëshmitë e shumë bashkëvuajtësve kosovarë ende vazhdojnë të trajtohen në formën e tregimeve, duke munguar vullneti për ti shkruar ato. Kujtimet dhe përjetimet e tyre përbëjnë fakte të rëndësishme, të cilat duhet ti bashkangjiten historisë së shkruar të Kosovës si dhe do ti përcaktonin gjykimin e shumë momenteve kyçe, si rastet e masakrave ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë.

BIBLIOGRAFIA

Literatura e shfrytëzuar:

Zejnullah, Jusuf: *Stuhi luftë mbi Kosovë*, 2007, Tiranë (ISBN- 9789994312573, 999431257X)

V. Krasniqi, Sadik: *Lufta për çlirimin e Kosovës*, 2009, Prishtinë

Ahrens, Geert-Hinrich: *Diplomaci mbi tehun e thikës*, 2010, Tiranë (ISBN- 9789994315352)

Meier, Viktor: *Fundi i Jugosllavisë- Goditja në Kosovë*, 2006, Lubjanë (ISBN- 9619197305, 9789619197301)

Abazi, Enika: *Çështja e Kosovës dhe Diplomacia Ndërkombëtare (1991-1999): Një konflikt i parashikueshëm*, 2012, Tirana

Krasniqi, Jakup: *Lëvizja për Republikën e Kosovës*, 2011, Prishtinë (ISBN 9789951081405)

Pellet, Alain: *Opinionet e Komitetit të Arbitrazhit Badinter: Një Frymë e Dytë për Vetëvendosjen e Popujve*, 1992, European Journal of International Law (ISSN-09385428)

Hasani, Enver: *Vetëvendosja, integriteti territorial dhe stabiliteti ndërkombëtar: Rasti i Jugosllavisë*, 2003, Prishtinë

Këpuska, Avni: *Qenësia e territorit dhe kufijve etnikë autoktonë të Kosovës*, 2004, Prishtinë

Biermann, Rafael: *Dështimi i preventives ndërkombëtare të konfliktit*, 2006, Gjermani

Métais, Serge: *Histori e shqiptarëve: Nga Ilirët deri tek pavarësia e Kosovës*, 2006, Tiranë (ISBN- 9994388134, 9789994388134)

Shala, Blerim: *Vitet e Kosovës 1998-1999*, 2003, Prishtinë

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut: *Krimet e Luftës në Kosovë 1998-1999*, 2010, Prishtinë

Talla, Nazmi: *Kronikë e një vrasjeje (Dëshmorit Fadil Talla)*, 2009, Prishtinë

Materiale nga Interneti:

<https://www.voal.ch/me-20-shkurt-1989-minatoret-e-trepces-nisen-greven-historike/>

<https://www.arbresh.info/lajmet/ruajtjen-e-kufijve-e-parasheh-edhe-komisioni-i-badinterit/>

https://www.hrw.org/sites/default/files/reports/Under_Orders_AI_Combined.pdf

https://sq.wikipedia.org/wiki/Lufta_e_Kosov%C3%ABs

<https://www.hrw.org/legacy/albanian/kosovo2001/summary.pdf>

http://www.kipred.org/repository/docs/RAPORTI_KOSOVAR_466917.pdf

https://www.hrw.org/sites/default/files/reports/Under_Orders_AI_Combined.pdf